



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në zbatim të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 2 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, dhe nenin 15.2 shkronja d) të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur më 18 janar 2018, miratoi këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR MBARËVAJTJEN E PROCESIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 1

Për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës, formohet Komisioni, në përbërje:

- Hasan Ajeti
- Florent Hasani
- Rafet Llapashtica

Komisioni fillon punën menjëherë dhe ka mandat deri në kumtimin përfundimtarë të rezultateve të votimit, përkatësisht zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit.

Neni 2

Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është që të kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të votimit, të bëjë numërimin e votave dhe t'i komunikoj rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me procesin e votimit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-060/05-0004468/18
Podujevë,
18 janar 2018



Kryesuesi i mbledhjes
Mehmet Gashi